

20161894163

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR NGARKIM TË REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË ME KREDI TE BANKA KREDITORE PËR RINDËRTIM („KFW“)
SIPAS MARRËVESHJES PËR KREDI PËR PROJEKTIN PËR UJITJEN E RAJONIT
JUGOR TË VARDARIT**

Neni 1

Në Ligjin për ngarkim të Republikës së Maqedonisë me kredi të Banka Kreditore për Rindërtim ("KFW") sipas Marrëveshjes për kredi për Projektin për ujitjen e rajonit jugor të Vardarit, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 61/2002) neni 6 ndryshohet si vijon :

“Shfrytëzues i mjeteve të kredisë nga neni 1 i këtij ligji është Republika e Maqedonisë, ndërsa shfrytëzues të fundit të sistemeve për ujitje të ndërtuara në kuder të “Projektit për ujitje të rajonit jugor të Vardarit” të financuar nga kjo kredi do të jenë kooperativat bujqësore.

Republika e Maqedonisë, kredinë nga neni 1 i këtij ligji do ta paguajë nga Buxheti i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.